



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, neneve 14 dhe 15 parag. 2.4 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, si dhe në pajtim me nenin 35 shkronja o), dhe 37 pika 4 të Rregullores së Komunës së Podujevës për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes nr.01/18-02 të datës 31 janar 2011, në zbatim të Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 2019 – 2023, dhe rekomandimeve nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 22 nëntor 2019, mori,

VENDIM PËR VËNIEN NË DISKUTIM PUBLIK

Neni 1

Vëhet në diskutim /debat publik,

- **Draft Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2022, në Komunën e Podujevës**

Neni 2

Diskutimi publik sipas nenit 1, zgjat 30 ditë përkatësisht prej **22 nëntor 2019 deri më 22 dhjetor 2019**, dhe debati publik me qytetarë mbahet më **02 dhjetor 2019** duke filluar nga **ora 11:00**, në objektin kryesor të Komunës - salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes të debatit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e Komunës zyra nr.32, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresat; nazmi.elezi@rks-gov.net dhe bujar.gimolli@rks-gov.net, të cilat pastaj i përcjellin në Drejtorinë përkatëse.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>

Neni 5

Diskutimi / debati publik zbatohet nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, në koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, që përkujdesen për përgatitjen e raportit nga diskutimi / debati publik dhe të japin sqarime për arsyeshmërinë e pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.


Nr. 01-070/05-0089761/19
Podujevë,
22 nëntor 2019



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi



DRAFT STRATEGJIA E
ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL
2020-2022



KOMUNA E PODUJEVËS
DHJETOR 2019

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

Përmbajtja	
Lista e Figurave	3
Lista e Shkurtesave.....	4
Ekipi Punues.....	6
Hyrje.....	7
Metodologjia.....	8
Përgaditja e Mjetëve	8
Mbledhja e të dhënave.....	9
Analiza Sektoriale	9
Planifikimi Strategjik.....	10
Të dhënat gjeografike dhe demografike	11
Sektori privat.....	12
Demografia e Bizenseve në Podujevë.....	12
Tregtia	13
Prodhimtaria	13
Sfidat e Sektorit Privat në Podujevë	14
Bujqësia.....	15
Sektori i Pemëve.....	15
Sektori i Perimkulturës	16
Sektori i Bletarisë.....	17
Sektori i Blegtorisë.....	17
Nësektori i Mishit.....	18
Nësektori i Qumshtit.....	18
Arsimi	19
Menaxhimi i Arsimit dhe Administratës	19
Sigurimi i Cilësisë	20
Mjedisi Shkollor	20
Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve	21
Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	21
Sektori i Shëndetësisë	22
Mirëqenja Sociale	23

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

Ambienti dhe Shërbimet Publike	24
Menaxhim i Mbeturinave	24
Infrastruktura	25
Kultura, Sporti dhe Turizmi	26
Kultura	26
Sporti	26
Turizmi.....	27
Administrata	28
Trajnimet dhe Zhvillimi	28
Sistemet e Menaxhimit.....	28
Ofrimi i shërbimeve	29
Vlerat, Vizioni dhe Misioni	30
Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe Masat	31
Zhvillim I Qëndrueshëm Ekonomik.....	31
Zhvillim i Qëndrueshëm Social.	33
Menaxhim Qëndrueshëm.....	38

Lista e Figurave

Figura 1 Metodologjia e hartimit të SZHEL.	8
Figura 2 Shpërndarja e sektorëve ekonomik sipas numrit të bizneseve aktive, nivelit të qarkullimit dhe punësimit në përqindje	12
Figura 3 Shpërndarja e bizneseve në sektorin ekonomik të tregëtisë sipas numrit të kompanive, punësimit dhe qarkullimit.	13
Figura 4 Shpërndarja e bizneseve në sektorin ekonomik të prodhimit sipas numrit të kompanive, punësimit dhe qarkullimit.	13
Figura 5 Struktura e kultivimit të pemëve	15
Figura 6 Struktura e kultivimit të pemëve manore	16
Figura 7 Struktura e kultivimit të perimeve	16
Figura 8 Sipërfaqja e kullosave sipas pronësisë	17
Figura 9 Madhësia e kopesë sipas ekonomive bujqësore	18
Figura 10 Numri i të punësuarve ne sistemin e arsimit sipas viteve dhe niveleve	19
Figura 11 Numri i nxënësve sipas gjinisë dhe viteve	19
Figura 12 Përbërja e stafit shëndetësorë sipas profesionit	22
Figura 13 Numri i vizitave mjekësore në mjekësi familjare sipas grupmohave	22
Figura 14 Numëri i përfituesve nga skemat sociale dhe pensionale	23
Figura 15 Struktura infrastrukturore në Podujevë	26
Figura 16 Klubet sportive sipas statusit të funksionitmi	27
Figura 17 Numri i të punësuarve sipas kategorisë dhe grupmohës	28

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

Lista e Shkurtesave

AMF	Ambulanta e Mjekësisë Familjare
AMMK	Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ANQV	Analiza Vjetore për Nevojat e Qytetarëve
ANT	Analiza e Nevojave për Trajnim
ASK	Agjensioni i Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Europian
CEFTA	Marrëveshjes për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore
DACH	Gjermani, Austri, Zvicërr
DKA	Drejtoria Komuna e Arsimit
EIPSO	Ekipi për Imlementim të Planit Strategjik dhe Operacional
GIS	Sistemi Gjeografik i Pozicionimit
GP	Grup Punues
Ha	Hektarë
IHD	Invesitor të Huaj Direkt
KF	Këshillat e Fshatrave
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
KR	Këdet Rekreative
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MSA	Marrëveshjes e Stabilizim-Asociimit
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
OE	Operator Ekonomik
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
PCM	Cikli i Menaxhimit të Projektit
PESTEL	Analiza mbi faktoret: Politik, Ekonomik, Social, Teknologjik, Mjedisor dhe Ligjor

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

PKT	Programit të Këshillimit dhe Trajnimit
PMP	Profesionist në Menaxhim të Projekteve
PPP	Partneritet Publiko-Privat
PSO	Plani Strategjik dhe Operacional
QKDF	Qendra e Kujdesit Ditor për Fëmijë
QKDP	Qendra e Kujdesit Ditor për Pleqë
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
QR	Qendra Rinore
SHP	Shtëpi e Pleqëve
SISH	Sistemi Informativ Shëndetësorë
SKK	Strategjia Komunale për Komunikim
SËOT	Analiza mbi: Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet
SZHEL	Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal
TS	Terene Sportive
TVGI	Takimet Vjetore me Grupet e Interesit
TVQ	Takimet Vjetore me Qytetarë
UA	Udhëzim Administrativ

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

Ekipi Punues

Nexhmi Rudari – Nënkyetar I Komunës

Gëzim Namani – Drejtor i Administratës

Isuf Latifi – Drejtor për Buxhet Dhe Financa

Agim Blakqori – Drejtor i Arsimit

Zaim Thaçi – Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale

Hamdi Jaha – Drejtor i Urbanizmit dhe Mbrojtjes se Mjedisit

Abaz Llugaliu – Drejtor për Pronë Kadastër dhe Gjeodezi

Donika Sfishta – Drejtor për Kulture Rini dhe Sport

Faik Muçiçi – Drejtor për Sherbime Publike

Durim Salihu – Drejtor për Inspektion

Mirsad Kamerolli – Drejtor për Bujqesi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (Udhëheqës I Ekipit)

Ejup Babatinca – Udhëheqës i sektorit për Zhvillim Ekonomik (Menaxher i projektit)

_

Luan Dalipi – Udhëheqës i ekipit të MDA-së

Hamit Qeriqi – Ekspert ne politika lokale dhe zhvillim të qëndrueshëm

Ylber Beqiri – Ekspert i planifikimit strategjik

Bardhyl Musa – Menaxher i projektit

Hyrje

Në këtë dokument strategjik Komuna e Podujevës ofron vizonin dhe misionin, përcakton qëllimet strategjike, objektivat e matshme dhe mjetet për ta orientuar Podujevën drejt një komune të zhvilluar. Si i tillë përbën një obligim të përbashkët për të zhvilluar Podujevën si komunë funksionale, të përkushtuar në përmirësimin e jetës së qytetarëve, në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e mirëqenies sociale, ofrimin e shërbimeve publike cilësore, përfshirë arsimin dhe shëndetësinë, si dhe promovimin dhe përkrahjen e aktiviteteve kulturore dhe sportive.

Podujeva, që nga paslufta është ballafaquar me infrastrukturë të dobët, industri të rrënuar, institucione shkollore të vjetruara, administratë të trashëguar nga periudha e paraluftës, mungesë të shërbimeve adekuate shëndetësore e me shumë probleme të tjera që kanë shumëfishuar problemet sociale të qytetarëve. Gjatë 20 viteve të fundit pothuajse të gjitha investimet kapitale kanë shkuar në ndërtim të infrastrukturës rrugore, kanalizimeve, ndërtimin dhe ri-ndërtimin e shkollave dhe institucioneve shëndetësore duke kompletuar gati në tërësi infrastrukturën fizike të nevojshme për një qytet funksional.

Tani, ndër sfidat kryesore mbeten zhvillimi i ulët i sektorit të prodhimit, modernizimi i fermave dhe kultivimi i produkteve bujqësore me vlerë të shtuar, sigurimi i cilësisë në arsim dhe mjedis shkollor, ofrimi i shërbimeve sociale cilësore, rritja e numrit të shërbimeve nga institucione të kujdesit primar shëndetësor, si dhe zhvillimi i kulturës dhe sportit.

Kjo strategji paraqet një hap të rëndësishëm drejt realizimit të vizionit të Podujevës. Strategjia ofron zgjidhje praktike për shumë probleme aktuale që përmirësojnë pozicionin konkurrues të Podujevës në raport me komunat tjera. Konform këtij pozicioni konkurrues dhe kufizimeve buxhetore janë përcaktuar synimet dhe objektivat për periudhën 2020-2022.

Ky dokument është hartuar nga një ekip profesional i komunës dhe kompanisë MDA në bashkëpunim me komunitetin e biznesit, fermerë dhe përfaqësues të shoqatave bujqësore, punonjës të arsimit, shëndetësisë dhe nxënës.

Metodologjia

Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal (SZHEL) ka kërkuar një çasje gjithëpërfshirëse që përmban akterë nga institucione dhe fusha multi-disiplinare për shkak të rëndësisë ekonomike, gjeografike dhe sociale të Podujevës. Për këtë arsye, ne kemi parashikuar zbatimin e një metodologjie të punës e cila siguron pjesëmarrje të plotë të akterëve nga fushat kryesore që ndikojnë në zhvillim të qëndrueshëm.

Për hartimin e dokumentit strategjik janë ndjekur këto katër hapa kryesor:

Figura 1 Metodologjia e hartimit të SZHEL.



Përgaditja e Mjetëve

Si fazë fillestare e hartimit të strategjisë është përgaditja e mjeteve për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave. Gjatë kësaj faze janë identifikuar të dhënat e nevojshme për një analizë të mirëfilltë mbi gjendjen e sektorëve ekonomik dhe social. Për këtë janë zhvilluar formularë me të dhënat në vijim:

Administrata: Lista e stafit me të dhënat: Drejtoria; Kategoria funksionale; Grada; Titulli; Moshë; Paga; Kualifikimi; Gjinia.

Arsimi: Numri i Nxënësëve; Stafi i Angazhuar (administrative/akademik); Numri i Stafit Akademik sipas përgaditjes shkollore; Numri i Nxënësëve sipas largësisë së udhëtimit; Infrastruktura Bazike (Furnizimi i shkollës me ujë; Ngrohja; Qasja në kanalizim; Gjendja e objektit; Gjendja e Inventarit; Nr i dhomave të mësimit (Klasëve); Posedimi i mjeteve konkretizuese dhe kabinetët; Mesatarja e notës së nxënësëve për shkollën/paralelën; Mesatarja e testit të arritshmërisë.

Bujqësia: Sipërfaqja e mbjellur për secilën kulturë bujqësore, numri i fermerëve, numri i ekonomive bujqësore, kategorizimi i tokës, sipërfaqja me kullosa.

Urbanizmi dhe Shërbime Publike: Numri i rrugëve, gjatësia e rrugëve, gjatësia e rrugëve të asfaltuara, me kubëza dhe në zhavor, gjatësia e kanalizimit fekal, atmosferik, trotuareve, ndriçimit publik, ujësjellësit.

Zhvillim Ekonomik: Numri i bizneseve të regjistruara, numri i bizneseve aktive, vlera e qarkullimit për sektor dhe nën-sektor, numri i punëtoreve për sektor dhe nënsektor; vlera e eksportit për sektor dhe nënsektor;

Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale: Numri i anëtarëve të familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale; Pensionet bazike të moshës; Skema e pensioneve për vetëranët e luftës; Pensionet kontribut-pagues të moshës; Numri i familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale; Skema e pensionëve për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës; Pensionet e personave me nevoja të veçanta Skema për familjet me fëmijë me nevoja të veçanta (0-18) vjeç; Pensionet invalidore të punës; Numri i objekteve shëndetësore, gjendja e tyre, numri i vizitave, numri i ofrimit të shërbimeve, frekuenca e shërbimeve sipas viteve.

Kulture, Rini dhe Sport: Numri i organizatave jo-qeveritare rinore, numri i shfaqjeve dhe performancave artistike në teatër; numri i klubeve sportive sipas llojit të sportit.

Mbledhja e të dhënave

Për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për hartimin e strategjisë është dizajnuar plani i mbledhjes së të dhënave me ç'rast janë realizuar 11 intervista me drejtorë komunal dhe janë realizuar fokus grupe me fermer, përfaqësues të shoqatave të fermerëve, biznese, nxënës, arsimtarë, dhe punonjës të administratës komunale.

Për me shumë, janë marrë informata nga Agjensioni i Zhvillimit të Bujqësisë, Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Trusti Pensional dhe Administrata Tatimore e Kosovës.

Analiza Sektoriale

Pas analizës kuantitative dhe kualitative të të dhënave është bërë analiza sektoriale e cila është bazuar kryesisht në analizën SWOT dhe PESTEL:

Analiza SWOT, si metodë analitike, është përdorur për të identifikuar dhe për të kategorizuar përparësitë dhe dobësitë e brendshme, si dhe faktorët e jashtëm (mundësitë dhe rreziqet), me të cilat ballafaqohet komuna e Podujevës. Faktorët e jashtëm janë analizuar nëpërmjet metodës së analizës PESTEL, në mënyrë që të analizohen ndryshimet politike, ekonomike, socio-kulturore dhe teknologjike në mjedisin e institucionëve. Kjo ka ndihmuar në të kuptuarit e forcave të "imazhit të madh" të ndryshimit të ekspozuar.

Përmes këtyre analizave janë siguruar informacione të dobishme në lidhje me burimet dhe kapacitetet e Komunës në mjedisin ku ajo vepron. Për këtë arsye, analiza SWOT dhe PESTEL ka

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

dhënë një kontribut të rëndësishëm në procesin e planifikimit strategjik. Në këtë fazë janë përcaktuar edhe nevojat e komunitetit, por gjithashtu e një rëndësie të veçantë është përcaktimi i mënyrave të adresimit të atyre nevojave.

Planifikimi Strategjik

Pas hartimit të mbledhjes së të gjitha informatave sasiore dhe cilësore janë ndërmarrë hapa konkrete rreth hartimit të strategjisë. Pas analizimit të të dhënave të mbledhura nga intervistat, hulumtimeve sekondare, analizimit të të dhënave statistikore dhe analizës sektoriale, është krijuar një pasqyrë që ka reflektuar në gjendjen aktuale në sektorët e analizuar të zhvillimit ekonomik të Komunës së Podujevës.

Për hartimin e strategjisë është mbajtur një punëtori dy-ditore me drejtorë të drejtorive dhe udhëheqës të sektorëve kyç. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte analizimi i të dhënave dhe vendosja e prioriteteve dhe qëllimeve strategjike, objektivave specifike/projekteve/masave që duhet të ndërmerren për realizmin e vizionit të Komunës së Podujevës.

Profili i Komunës së Podujevës

Të dhënat gjeografike dhe demografike

Me një sipërfaqe prej rreth 633 km², Podujeva është komuna me e madhe e Kosovës sa i përket territorit. Shtrihet në pjesën veri-lindore të Kosovës, në luginën e lumit Llap, në një distancë prej rreth 121 km nga Shkupi, 280 km nga Tirana dhe 340 km nga Podgorica. Ajo kufizohet me pesë komuna tjera të Republikës Kosovës (Prishtinë, Vushtrri, Mitrovicë, Obiliq, dhe Leposaviq) dhe nga ana veri-lindore kufizohet me Serbinë. Kjo pozitë e mire gjeografike dhe rruga ndërkombetare M25 ka bërë që ndër sektorët me të zhvilluar të Podujeves të jetë tregtia. Në territorin e Komunës së Podujevës, relievi është i larmishëm, përbëhet nga male të shumta, me majën më të lartë që është maja e Albanikut me 1770 metra. Gjithashtu, ajo përmban male si Prugovci, Braina, malet e Turuqicës e Herticës, majet e të cilave nuk e kalojnë 1100 metra. (Komuna e Podujevës 2012).

Sipas vlerësimit të popullsisë në vitin 2012, nga Agjensioni i Statistikave të Kosoves (ASK) Podujeva ka 89185 banorë, prej të cileve 26% jetojnë në zona urbane dhe 74% në zona rurale. Komuna e Podujevës karakterizohet me popullsi të re në moshë. Mbi 57% e popullsisë së Podujevës janë nën moshën 30 vjeçare. Sipas gjinisë, popullsia e Komunës së Podujevës është pothuajse e balancuar ku 50.8% e popullsisë janë meshkuj ndërsa 49.2% janë femra, kurse sa i përket personave të moshës mbi 15 vjeç ekonomikisht jo-aktiv llogaritet të jenë rreth 30000. Sa i përket nivelit të arsimit, mbi 50% e popullsisë kanë përfunduar shkollimin e mesëm, të lartë, apo studimet pas-universitare.

Në territorin e Podujeves gjenden dy depozitat minerale ndër më të medhaja në Kosove. Miniera e Çuka e Batllavës dhe Depozita e Bellasicës të pasura me plumb, zink, argjend dhe minerale si silicified antigoritë, sphaleritë, piritë-limonitë, klorin, galenitë, kuarc, feldspat, karbonat, zirkon, turmalinë, muscovitë etj. Gjithashtu, një burim tjetër natyror i rëndësishëm për Komunën e Podujeves është edhe Banja e Sallabajës, burim natyror i ujit termo-mineral i cili është provuar se kuron shumë sëmundje. Temperatura e burimit në këtë banjë është rreth 23°C.

Klima në Podujeve konsiderohet si klimë e mesme – kontinentale, temperaturë mesatare vjetore që sillet të jetë rreth 9.3° C. Sasia mesatare e të reshurave në Komunën e Podujevës është 697 mm, që është nën mesatarën e Kosovës (784 mm). Kurse, sa i përket hidrologjisë, Komuna e Podujevës posedon ujë në formë të lumenjëve, si dhe liqeneve. Disa nga lumenjtë e Komunës së Podujevës janë: lumi i Dumnicës, Lumi Batllava, Lumi i Kaqandolit, Vrella e Revuçit, dhe Lumi i Llapit i cili është lumi me më së shumti prurje të ujit. Rezervati me i madh në Komunën e Podujeves është Liqeni Artificial i Batllavës. Nga ky liqen furnizohën me ujë banorët nga Podujeva, gjysma e Prishtinës, Lipjani e vende të tjera përreth. Ujësjellësi nga liqeni fabrikon 34 milion kub ujë brenda një viti.

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

Gjurmë të vendbanimeve të lashta janë gjetur në shumë vendbanime të Podujevës. Arkeologët tregojnë se në këtë regjion kanë ekzistuar disa vendbanime dhe gërmadha të objekteve të lashta si Vendenisi, Kalaja e Ballocit, Vendbanimi mesjetar i Bellasicës, Gërmadha e Kishës së Përandorit Konstandin dhe përandorshës Helena në Orllan dhe Gërmadhat e një kishe dhe varrezave në Pollatë.


Sektori privat

Zhvillimi i sektorit privat që nga paslufta kryesisht është ndihmuar nga organizatat dhe projektet ndërkombëtare, megjithatë roli i bizneseve, e posaçërisht i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) ka qenë i lartë në zhvillimin ekonomik lokal, sidomos në krijimin e vendeve të punës.

Demografia e Bizenseve në Podujevë

Komuna e Podujevës numëron gjithsej 4869 biznese të regjistruara, prej të cilave 1021 apo 21% janë aktive. Kjo gjendje nuk ndryshon shumë prej nivelit kombëtar, ku raporti në mes ndërmarrjeve të regjistruara dhe atyre aktive është 22%.

Figura 2 Shpërndarja e sektorëve ekonomik sipas numrit të bizneseve aktive, nivelit të qarkullimit dhe punësimit në përqindje



Nga numri i bizneseve aktive me seli në Komunën e Podujevës, 37% bëjnë pjesë bizneset nga sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë, 15% sektori i prodhimit dhe sektori i ndërtimit me 10%.

Sa i përket shitjeve, bizneset e Komunes së Podujevës pranojnë dhe bëjnë transaksione si total mesatarisht nga 144 milion Euro deri në 163 milion Euro në vit. Në raport me nivelin kombëtar, vlera e transaksionëve të bizneseve të Komunes së Podujevës është rreth 2%. Nga viti 2016 deri në vitin 2018, vlera e qarkullimit ka pasur një rritje mesatare vjetore prej 3%, kurse rritja e përgjithshme ka shënuar 6%. Vlen të theksohet se sektori i bujqësisë ka treguar rritje mesatare vjetore më të lartë me 19%, kurse rritjen e përgjithshme me 41%. Tregtia mbetet si sektori më i madh sa i përket vlerave të qarkullimit me 56%, prodhimi me 19% dhe transporti me 12%.


DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

Bazuar në të dhënat e Trustit Pensional të Kosovës, në total rreth 17000 përsone janë kontributdhënës të rregullt në Komunën e Podujevës. Nga viti 2016 deri në 2018, rritja mesatare vjetore e punësimit është 8% kurse rritja e përgjithshme 17%. Sektorët me përqindje më të lartë të punësimit janë: tregtia me 35%, prodhimi me 10% dhe sektori i ndërtimit me 12%.

Tregtia

Tregtia është njëri ndër sektorët më të zhvilluar dhe të rëndësishëm në komunën e Podujevës, gjithsej 322 kompani operojnë në sektorin e tregtisë.

Figura 3 Shpërndarja e bizneseve në sektorin ekonomik të tregëtisë sipas numrit të kompanive, punësimit dhe qarkullimit.




Nën-sektori i tregtisë me shumicë në Podujevë është më i zhvilluar se sa nën-sektori i tregtisë me pakicë. Edhe pse për nga numri i kompanive aktive është më i ulët, nën-sektori i tregtisë me shumicë arrin të punësojë rreth 8%, respektivisht të qarkullojë 14% më shumë se nën-sektori i tregtisë me pakicë.

Prodhimtaria

Sektori i prodhimit në komunën e Podujevës përbëhet nga gjithsej 231 biznese prodhuese aktive, prej të cilave 35% janë biznese që merren me prodhimin e bimëve, kafshëve, 21% me prodhimin e produkteve të ushqimit për njerëz dhe kafshë. Sa i përket punësimit, nën-sektori i prodhimit të produkteve të ushqimit dhe nën-sektori i prodhimit të bimëve dhe kafshëve përbën rreth 50% të punësimit në këtë sektor.

Figura 4 Shpërndarja e bizneseve në sektorin ekonomik të prodhimit sipas numrit të kompanive, punësimit dhe qarkullimit.



DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

Edhe pse komuna e Podujevës ka një numër të lartë të fermerëve të regjistruar dhe aktiv, numri i bizneseve aktive në sektorin e bujqësisë mbetet shumë i vogël. Aktualisht, 80 biznese janë aktive në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë, megjithatë mbetet njëri ndër sektorët me rritjen më të madhe ekonomike në 3 vitet e fundit.

Sfidat e Sektorit Privat në Podujevë

Prospekti industrial i Podujevës vazhdon të mbetet i fragmentizuar dhe i dobët, veçanërisht në industrinë me vlerë të lartë të shtuar. Kompanitë llapjanë që veprojnë në sektorin e prodhimit duhet të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të përmirësuar cilësinë e produkteve të tyre dhe të ballafaqohen me konkurrencën në rritje nga vendet e tjera, qoftë nga shtetët anëtare të Marrëveshjes për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA), apo edhe nga shtetët e Bashkimit Evropian (BE), si rezultat i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA).

Në anën tjetër, sfidë kryesore e sektorit privat mbetet prania e madhe e ekonomisë joformale, qoftë në aspekt të tregut të punës, por edhe në aspekt të pagesës së tatimeve tjera dhe pajtueshmërisë ligjore. Të dhënat mbi këtë temë ndryshojnë varësisht prej burimit të informatave, megjithatë variojnë nga sektori në sektor 30-50%. Ky fenomen e bën të pamundur për kompanitë që respektojnë ligjin që të konkurrojnë në një ambient të barabartë me ato kompani që për një arsye apo tjetër kanë vendosur të veprojnë në ekonomi të hirtë.

Mungesa e shkathtësive në sektorin e prodhimit është e evidentë. Në masë të madhe, bizneset nga sektorët e prodhimit raportojnë më shumë vështirësi në rekrutimin e punëtorëve me aftësitë dhe shkathtësitë e nevojshme. Sektorët e prodhimit kërkojnë shkathtësi më specifike të nevojshme për atë industri specifike. Kompanitë nga sektori i prodhimit në veçanti raportojnë vështirësi në gjetjen e punëtorëve me kualifikime teknike, të nevojshme në procese të prodhimit, si: makinist, saldues, zdrukthar, teknik të ushqimit, etj. Intervistat dhe takimet që kemi realizuar tregojnë se kompanive prodhuese në Podujevë ju nevojiten rreth më shumë se 3 muaj për të aftësuar një punëtor me shkathtësitë që i nevojiten në vend të punës.

Eksportët e kompanive llapjanë vazhdojnë të mbeten të ulëta, kurse synimi kryesor i tyre është qasja në tregje evropiane brenda një periudhe të shkurtë kohore. Në këtë aspekt sfidë kryesore e tyre është gjetja e tregjeve të huaja, ndërtimi i kapaciteteve të brendshme për eksport, planifikimi i eksportëve, certifikimi i produkteve dhe kompanive të tyre me standard të cilësisë si: ISO 9001:2015; ISO 14001; ISO 22000/HACAP; ISO 27001, CE mark, etj.

Komuna e Podujevës në bashkëpunim me donatorë të fokusuar në përkrahjen e sektorit privat, duhet të iniciojë projektë me bashkë-financim për përmirësimin e ambientit të të bërit biznes dhe përkrahjen e bizneseve prodhuese dhe eksportuese. Kjo mund të arrihet nëpërmjet: rritjes së shkathtësive të punëtorëve përmes sistemit të arsimit, rritjes së bashkëpunimit me inspektoratin e punës, inspektoratin e ATK-së, dhe përmes fasilitimit të bizneseve për gjetjen e tregjeve të reja.

Bujqësia

Bujqësia në Podujevë luan një rol shumë të rëndësishëm në ofrimin e mundësive në punësim dhe në krijimin e të ardhurave. Megjithatë, zhvillimi i bujqësisë në rajonin e Llapit mbetet në nivel të njëjtë edhe me komunat e tjera në raport me aftësitë konkurruese në tregun rajonal dhe të BE-së. Shkaktarët kryesorë të kësaj aftësie të ulët konkurruese janë përmasat e vogla të shumicës së bizneseve bujqësore, fragmentimi i tokës, ndërtësat dhe pajisjet e vjetra, mungesa e mjetëve financiare për investime dhe niveli i ulët i njohurive lidhur me teknologjinë bashkëkohore të prodhimit dhe rreth sigurimit të bleresve në tregjet e huaja. Përveç kësaj, shumica e fermave nuk i përmbushin standardet për siguri dhe higjienë të ushqimit, për mirëmbajtje të kafshëve dhe mbrojtje të mjedisit.

Duke marrë parasysh faktin se shumica e fermave janë shumë të vogla, duket e arsyeshme që të nxitët edhe bashkëpunimi horizontal ndërmjet bujqëve në formën e bashkëpunimit të prodhuesve, i cili mund të ndërtoj bazën për organizatat e mëvonshme prodhuese. Gjithashtu, është e rekomandueshme të nxitët bashkëpunimi me shoqatat e prodhuesve për integrimin vertikal të bujqve (psh., prej 'qumshtit' tek 'fabrika përpunuese' tek 'ndermjetësuesi për shitje të produkteve të qumshtit në tregun vendor dhe nderkombëtar').


Me qëllim të përparimit të metodave të punës dhe zbatimit të inputëve cilësorë duhet të rritët numri i agronomëve dhe të nxitën fermerët e rinj të moshës prej 18 deri 40 vjeç, të cilët përfaqësojnë bazën për një sektor bashkëkohor dhe inovativ bujqësor.

Në bazë të këtij shqyrtimi, por edhe të përparësisë krahasuese në të cilën Podujeva ka në disa sektorë, subvencionimi i bujqëve duhet të përqendrohet në këta sektorë:

Sektori i Pemëve

Si rezultat i kushtëve të mira, Podujeva ka një traditë të gjatë të kultivimit të pemëve. Pemët

Figura 5 Struktura e kultivimit të pemëve




manore përbëjnë pjesën më të madhe sa i përket sipërfaqës. Mollat dhe kumbullat janë kryesisht të kultivuara në kopshtët e shtëpive dhe me kultivim ekstënsiv, vitët e fundit kanë filluar me kultivim intënziv. Sipërfaqet me arra dhe lajthi janë të pakta, kryesisht pemë që ndodhen në oborre të shtëpive dhe shumë pak në pemishtë intënsive. Kërkesa për arrë dhe lajthi ka shënuar rritje të madhe në tregun kombëtar dhe

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

ndërkombëtar. Megjithatë, prodhimi vendor në shumicën e prodhimeve nuk arrin vetëmjaftueshmërinë gjë që len hapësirë për zgjerimin e sipërfaqeve me prodhim intenziv. Momentalisht prodhuesit e pemëve ballafaqohen me disa probleme si, pemishtët e vjetra, varietetët me cilësi të dobët, paisjet e dobëta për klasifikim dhe paketim për tregtim.

Tregu kërkon sasi të vazhdueshme dhe konsistentë të pemëve me cilësi të lartë. Kështu që, Komuna e Podujevës duhet të synojë intensifikimin e prodhimit të pemëve në një sipërfaqe më të gjerë dhe arritjen e standardeve të cilësisë.

Figura 6 Struktura e kultivimit të pemëve manore




Në sektorin e pemëve manore, si pasojë e çmimeve të ulëta, në dy vitët e fundit ka patur një rënie në sipërfaqe. Për këtë Komuna e Podujevës duhet të rrisë sipërfaqet dhe me aroni, boronica, dredhëza industriale në mënyrë që të bëhet fragmentimi i kulturave dhe plantacionëve me pemë manore. Gjithashtu, në zona të caktuara të subvencionojë sistemin kundër breshërit.

Sektori i Perimkulturës

Sektori i perimtarisë, pavarësisht shtrirjes së vogël, është më premtuesi për Podujevën, pasi që ka kushtë të mira kultivimi dhe mund të sigurojë rritje të mirë të vlerës së shtuar. Sektori i perimtarisë përbëhet nga rreth 200 kultivues komercial dhe një numër më i madh i kultivuesve gjysmë komercial dhe ekzistencial. Kulturat në perimkulturë mbetën: speci, lakra dhe patatja. Sektori dominohet nga ferma të vogla private me sipërfaqe mesatare prej 0.94 Ha me prodhimtari dhe rendimentë që variojnë nga viti në vit me shpenzime të larta për grumbullim dhe logjistikë. Tregtimi i perimeve të freskëta shpesh bëhet pa paketim të përshtatshëm dhe pa klasifikim të prodhimeve.

Figura 7 Struktura e kultivimit të perimeve



Subvencionimi i vazhdueshëm për ndërtimin e serrave ka bërë të rritët prodhimi për nevoja familjare. Megjithatë, nevoja për perime të freskëta gjatë tërë vitit është në rritje, prandaj mungesa e kapacitetëve prodhuese ka bërë që tregu vendor të furnizohet kryesisht nga importi prej vendeve të ndryshme. Si nevojë urgjente është edhe zgjerimi i hapësirave dhe ndërtimi i depove për trajtim

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

pas vjeljes, rritja e vazhdueshme e sipërfaqeve me serra, dhe kultivimi intenziv i përimkulturave në serra, pasi që prodhimi intenziv në serra kërkon më shumë fuqi punëtore sesa në fusha të hapura.

Sektori i Bletarisë

Sektori i bletarisë ka një shtrirje të madhe në komunën e Podujevës. Ai përbëhet nga rreth 700 bletërritës me mbi 7000 koshere bletë në total. Ky sektor ka qenë i përkahur shumë në menyrë horizontale nga komuna, por edhe nga organizata të tjera me subvencionim direkt të bletëve. Zhvillimi i hovshëm i bletarisë në Podujevë, sidomos në tri vitët e fundit ka rritur prodhimin e mjaltës, por jo edhe të produktevetjera të bletës (propolisi, qumështi i bletës, poleni etj). Bletarët janë të organizuar nëpërmjet 3 shoqatave ku në vazhdimësi mbajnë trajnime dhe ligjerata për bletarët e rinj, megjithatë edukimi i bletarëve mbetet njëra ndër sfidat kryesore të Komunës dhe shoqatave. Mungesa e kapaciteteve komunale dhe të shoqatave në menaxhimin e sektorit të bletarisë theksohet kryesisht regjistrimin detaj të bletishtëve, krijimin e pasaportës së bletës, inventarizimin dhe lokalizimin e bletëishtëve, kultivimin e bimëve mjaltës-dhënëse dhe krijimin e listës së sigurtë të barnave për bletët.

Subvencionimi i Komunës kryesisht duhet të përqëndrohet në zhvillimin vertikal të bletarisë në Podujevë, nëpërmjet avansimit të bletarëve në aspektin profesional, zgjerimin e produktevetë bletës, kontroll, dhe shitje / eksport.

Sektori i Blegtorisë


Blegtorija mbetet një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë në Podujevë duke kontribuar në masë të madhe ndaj vlerës së përgjithshme të prodhimeve bujqësore. Podujeva karakterizohet me kullosa dhe livadhe të përshtatshme për zhvillim të blegtorisë. Aktualisht, sipërfaqja e tokës së kullotur kalon vlerën prej 9000 Ha, kryesisht në toka të përbashkëta. Blegtorija ka një shtrirje të gjerë dhe kryesisht popullohet nga gjedhet dhe lopët qumështore. Numër i madh i krerëve të lopëve dhe gjedheve mbahen dhe rriten në ekonomi familjare, për më

Fondi blegtoral		
	Numri i ekonomive bujqësore	Numri i krerëve
Gjedhe gjithsej	4771	14624
Buallica	4	8
Dele	111	7528
Dhi	55	630
Kuaj, gomare dhe mushka	63	65
Shpeze	4340	149468

shumë janë identifikuar mbi 600 fermer që rrisin më shumë se 5 krerë lopë. Si rezultat i migrimeve fshatqytet por edhe faktorëve tjerë, fondi blegtoral mbetet i ulët në raport me numrin e ekonomive familjare.

Aktualisht, në territorin e Komunës së Podujevës numërohen rreth 80 ferma të lopëve dhe gjedheve që kryesisht zhvillohen në nënsektorin e qumështit dhe mishit.

Figura 8 Sipërfaqja e kullosave sipas pronësisë



DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022


Nësektori i Mishit

Mishi i gjedhit tradicional konsiderohet si nën-produkt i sektorit të blegrorisë. Të gjithë viçat vijnë nga fermat prodhuese të qumështit që nënkupton se nuk ekziston një zinxhir furnizimi i mishit i kompletuar dhe specializuar. Shtallat për majmëri janë kryesisht objektë të konvertuara nga objektët për prodhimin e qumështit ose objektë të ndërtuara nga vetë fermerët e vegjël. Për të shtuar profesionalizimin në mbarështimin e gjedhëve për mish është e nevojshme të përmirësohen njohuritë teknike të prodhuesve, sidomos atyre fillestarë rreth praktikave të mbarështimit të gjedhëve për mish dhe prodhimit të ushqimit për kafshë duke iu përshtatur trajnimin dhe shërbimin këshillues. Përveç kësaj, fermerët e gjedhëve për mish kanë nevojë për investime në stalla dhe objektë ndërtimore, investim në makinëri për prodhimin e ushqimit për kafshë në përputhje me standardet ekzistuese për mirëqenie të kafshëve dhe mjedisit. Gjithashtu, paisje si: sistemi i furnizimit me ujë, sistemi i të ushqyerit, sistemi i largimit të plehut të stallës, makinëritë e fermës për prodhimin, ruajtjen, përgaditjen, përdorimin dhe shpërndarjen e ushqimit janë të nevojshme për ngritjen e funksionalitetit në këtë sektor.

Nësektori i Qumështit

Qumështi i lopës është prodhimi më i rëndësishëm blegtoral në Podujevë. Viteve të fundit janë bërë përpjekje që prodhimi i qumështit të kalojë nga prodhimi për konsum familjar në prodhim për treg. Problemet kyçe mbetën kushtët e mbarështimit, praktikat e mira bujqësore në fermat prodhuese të qumështit dhe kapacitetet e bujqëve për prodhim të qumështit me cilësi të lartë.

Figura 9 Madhësia e kopësë sipas ekonomive bujqësore



Në Komunën e Podujevës aktualisht nuk ka pikë grumbulluese të qumështit apo nënprodukteve të qumështit. Kompanitë prodhuese të qumështit vijnë dhe ua marrin qumështin fermerëve nga shtallat e tyre me çmime shumë të ulëta. Prodhimi i produkteve të qumështit nga fermerët siç janë kosi, maza, gjiza, djathi etj. bëhet kryesisht për konsum familjar e në


masë shumë të vogël për tregtim në rrethin e ngushtë familjar.

Komuna e Podujevës gjatë viteve të kaluara ka përkrahur këtë sektor me subvencionimin e paisjeve për mjelje, megjithatë ky sektor ka ende nevojë për investime në modernizim e stallave dhe paisjen e stallave me sistem të furnizimit me ujë, sistemi të ushqyerit, sistemi të largimit të plehut të stallës, makinërinë e fermës sidomos për prodhimin, ruajtjen, përgaditjen, përdorimin dhe shpërndarjen e ushqimit. Përveç kësaj, komuna duhet të bëjë përpjekje për rritur ndërgjegjësimin e fermerëve ndaj ndotjes së mjedisit, sidomos ndikimit që lëngu i plehut mund të ketë tek ujërat nëntokësore.

Arsimi

Arsimi në Podujevë përbëhet nga gjithsej 61 institucione arsimore, prej të cilave 41 janë institucione amë dhe 20 paralele të ndara. Nga 41 shkolla amë, një i takon nivelit parashkollor, 37 nivelit fillor dhe të mesëm të ulët dhe 3 nivelit të arsimit të mesëm të lartë.

Figura 10 Numri i të punësuarve ne sistemin e arsimit sipas viteve dhe niveleve




Në institucionet edukativo-arsimore publike në Komunën e Podujevës, punojnë 1451 punonjës prej të cilëve 1184 mësimdhënës, 92 personel administrativ dhe 175 personel ndihmës. Në vitin shkollor 2018/2019, nga 1184 mesimdhënës 937 kanë qenë të angazhuar në nivelin fillor dhe

të mesëm të ulët, 237 në arsimin e mesëm të lartë dhe 8 mësimdhënës në nivelin e arsimit parashkollor.

Nga viti shkollor 2015/2016, në vitin shkollor 2019/2020 ka rënie të numrit të nxënësve për 5.7%, kurse rënia mesatare vjetore e numrit të nxënësve në Komunën e Podujevës është 0.37%.

Figura 11 Numri i nxënësve sipas gjinisë dhe viteve



Raporti mësimdhënës/nxënës vazhdon të qëndrojë në kuotat mesatare në krahasim me mesataren në Kosovë. 1/18.7 në nivelin e arsimit të mesëm të lartë. 1/14.9 në nivelin e arsimit të parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët dhe 1/7.8 në nivelin e arsimit parashkollor.

Menaxhimi i Arsimit dhe Administratës

Momentalisht, shkollat në Komunën e Podujevës kanë themeluar këshillat drejtuese të shkollave, këshillat e prindërve dhe këshillat e nxënësve. Funkcionimi i këtyre strukturave në shkolla ka nevojë ende për rritje të efektshmërisë në rolin dhe funksionet e tyre. Funkcionalizimi i këshillave drejtuese në shkolla duhet të përmirësohet duke fuqizuar rolin e prindërve dhe anëtarëve të tjerë në këshilla. Në anën tjetër, drejtorët e shkollave kanë përfunduar aftësimin profesional dhe trajnimet për pozita udhëheqëse në shkolla. Kjo mund të konsiderohet si përparësi, pasi që trajnimet e ardhshme lidhur me menaxhimin e shkollave mund të orientohen në adresimin e nevojave tjera si pershembull: menaxhimi financiar.

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

Si rrjedhojë e mungesës së kapacitetëve dhe aftësive për menaxhim financiar bazuar në rregullat në fuqi, por edhe të numrit të vogël të nxënësve në disa shkolla, kanë bërë që buxheti i shkollave të jetë ende i centralizuar.

Nepërmjet e organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare, por edhe nepërmjet buxhetit vetanak komuna mundë të siguroj aftësimin e mësimeve sipas nevojave të tyre. Gjithashtu DKA duhet të rrisë bashkëpunimin mes shkollave në vend dhe jashtë, në mënyrë që mësimit dhe nxënësit e tyre të përfitojnë nga shkëmbimi i praktikave të suksesshme.

Vitëve të fundit, DKA në Podujevë ka qenë pjesë e vazhdueshme e projekteve ndërkombëtare që kanë pasur synim ngritjen e nivelit menaxherial dhe kapaciteteve të mësimit.

Sigurimi i Cilësisë

Strategjia për Sigurimin e Cilësisë e miratuar në vitin 2016, ka shtuar obligimet komunale në funksion të sigurimit të cilësisë në sistemin e arsimit. Në Komunë tashmë janë ndërmarrë disa aktivitete për zbatimin e kësaj strategjie, ku janë caktuar koordinatorët e cilësisë në të gjitha shkollat e Komunës. Shumica e këtyre koordinatorëve kanë ndjekur trajnimet e ofruara nga Ministria e Arsimit. Megjithatë ngritja e kapacitetëve të koordinatorëve por edhe të drejtorëve të shkollave duhet të orientohet edhe në drejtim të realizimit të vetë-vlerësimit të shkollave.

Gjithashtu, një barrierë në fushën e sigurimit të cilësisë është edhe pamundësia financiare e Komunës të shtrijë dhe funksionalizojë shërbimin pedagogjik dhe psikologjik në shkolla. Për më shumë, si sfida e theksuar e DKA-së mbetet monitorimi, vlerësimi, analizimi dhe raportimi standard dhe i mirëfilltë i performancës së mësimeve, menaxhmentit të shkollë dhe zbatimit të kurrikulës. Për realizimin e një procesi standard të monitorimit dhe vlerësimit kërkohet ngritje e kapacitetëve profesionale të stafit në nivel Komunë dhe shkolle.

Mjedisi Shkollor

Në Komunën e Podujevës, shkollat punojnë kryesisht në dy ndërrime. Në përgjithësi, gjendja infrastrukturore është vlerësuar të jetë e mirë, me përjashtim të shkollës në Llapashticë dhe Metehi, ku edhe janë në proces të ndërtimit të shkollave të reja, megjithatë zgjerimi i hapësirës ekzistuese është e rëndësishme për të rritur efikasitetin e punës me nxënës. Zgjerimi i hapësirës për rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në edukim parashkollor është më i theksuar, në të njëjtën kohë ekziston nevoja për të përmirësuar mirëmbajtjen e hapësirave shkollore dhe jashtë shkollore.

Nga 41 institucione arsimore në Komunën e Podujevës, 59% e shkollave janë të kyçura në sistemin e ujësjellësit, 41% e tyre furnizohen nga puset, kurse 94% janë të kyçur në sistemin e kanalizimit, pjesa tjetër e shkollave përdorin gropat septike.

Me hyrjen në fuqi të planprogramit të ri, mjetet konkretizuese dhe pajisja e shkollave me laboratorë dhe kabinetë është e domosdoshme. Në këtë kuptim, komuna e Podujevës ka bërë

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

inventarizimin në një numër të shkollave, megjithatë duhet përmirësim në këtë fushë, sidomos në mirëmbajtje dhe në furnizim të laboratorëve dhe kabinetëve me material hargjues.

Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

Komuna ka bashkëpunuar me organizata të ndryshme për zhvillim profesional të mësimdhënësve. Në përgjithësi, këto trajnime janë realizuar në nivel të Kosovës ose në regjional për tema të përgjithshme. Për më tutje, është e rëndësishme që të zhvillohet vlerësimi i nevojave për trajnime për të gjithë mësimdhënësit në Komunën e Podujevës, duke u bazuar në analizat dhe qasjet si më poshtë:

- Analizën e Kompetencave
- Analizën e Përmbajtjes
- Analizën e Boshllëqeve
- Vlerësimin e Nevojave
- Analizën e Përformancës
- Analizën e Deficitit të Përformancës.

Bazuar në të gjeturat nga vlerësimi i nevojave për trajnim, DKA në koordinim me MASHT duhet të zhvillojë programin e trajnimit dhe t'a implementojë sipas të gjeturave të vlerësimit.


Tani për tani, komuna e Podujevës nuk ka mjete financiare për të mbuluar koston e zhvillimit të vazhdueshëm profesional për mësimdhënësit. Prandaj, DKA duhet të krijojë mekanizma brenda-shkollor nëpërmjet organizatave të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare që punojnë me zhvillimin profesional të mësimdhënësve, për të siguruar qëndrueshmëri të zhvillimit profesional të vazhdueshëm për mësimdhënësit.

Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale

Komuna e Podujevës ka rritur angazhimin dhe projektet për përmirësimin e sektorit shëndetësor dhe të mirëqenies në Podujevë. Përmirësimet janë bërë duke filluar nga ndërtimi i qendrave të reja të mjekësisë familjare, furnizimi me pajisje të reja dhe moderne mjekësore për qendrat e mjekësisë familjare, dhe furnizimi i rregullt me inventar. Ngjashëm, është angazhuar edhe në fushën e mirëqenies sociale, veçmas në zgjidhjen e çështjes së banimit për banorët në lagjen e dëshmorëve, ku në bashkë-financim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale kanë ndërtuar dhjetra shtëpi. Megjithatë, duke marrë parasysh kompetencat e nivelit komunal për këta dy sektorë, e posaçërisht për mirëqenien sociale, vlen të thuhet që Komuna e Podujevës i ka të limituara kompetencat ligjore por edhe kapacitetet financiare për të ofruar mbështetje më të madhe sociale për qytetarët e saj.

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

Figura 12 Përbërja e stafit shëndetësorë sipas profesionit




Sektori i Shëndetësisë

Shërbimet shëndetësore të mbrojtjes primare për qytetarët e Komunës së Podujevës ofrohen përmes Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, 4 Qendrave të Mjekësisë familjare dhe 18 Punktëve Shëndetësore në pjesët rurale.

Në QKMF janë të punësuar gjithsej 246 punonjës prej të cilëve 55 mjekë/mjekë specialistë, 132 infermierë, mami, teknikë dhe laborantë, 7 stomatologë dhe 52 staf jo-shëndetësor.

Shërbimet funksionale në QKMF janë: shërbimi emergjent, reparti i stomatologjisë, farmacisë, infermierisë, materniteti me ambulante gjinekologjike, pediatriisë, pulmologjisë dhe radiologjisë, laboratorik, këshillimorja për hipertension dhe diabet, shërbimi specialistik, (Intërnisti, Dermatologu, Oftamologu) dhe shërbimi i vaksinimit. Këto qendra kryejnë shërbime të kujdesit parësor mjekësor si: Përparimi, parandalimi, mjekimi, shërimi dhe rehabilitimi që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet; imunizimin dhe vaksinimin, kujdesin themelor stomatologjik, zbulimin e hershëm të sëmundjeve ngjitëse, kryerjen e shërbimeve specialistike dhe diagnostiko-analizave laboratorike dhe të rengenit në kujdesin parësor shëndetësor.

Figura 13 Numri i vizitave mjekësore në mjekësi familjare sipas grupmoshave



Në vitin 2018 numri total i vizitave në QKMF ishte 295,595 kurse numri i shërbimevetë ofruara ishte 401,597. Me se shumti janë evidentuar vizita në mjekësi familjare. Numri i vizitave në mjekësi familjare në vitin 2018 ka qenë 53917 dhe ka shënuar rritje për 10% nga viti 2017, në anën tjetër më së paku vizita janë evidentuar në ambulanten stomatologjike.

Njëra ndër përparësitë më të mëdha të shëndetësisë në komunë janë infrastruktura pothuajse e kompletuar e rrjetit të objekteve shëndetësore, megjithatë probleme kyçe mbetën inventarizimi i objekteve shëndetësore me pajisje medicinale si dhe numri i pamjaftueshëm i stafit shëndetësor.


Si sfida të rëndësishme që vlen të theksohen janë edhe mungesa e Ligjit për Sigurime Shëndetësore, furnizimi i pamjaftueshëm me barna dhe material tjetër shpenzues mjekësor nga ana e MSH, kompetencat e limituara të Komunës për menaxhimin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, mos-funksionalizimi i Sistemit të Informimit Shëndetësor dhe kufizimet në rekrutimin e stafit të ri, mungesa e një sistemi standard të monitorimit të institucionëve shëndetësore dhe mos-funksionalizimi i spitalit të qytetit.

Megjithatë, në kuader të shërbimit laboratorik është shumë e nevojshme rritja e numrit të sheëbimeve laboratorike, si dhe shtrirja e disa shërbimeve laboratorike edhe QMF dhe AMF.

Mirëqenja Sociale

Me decentralizimin e shërbimeve sociale, komunat kanë marrë përgjegjësi të theksuara për sa u përket ofrimit të shërbimeve sociale në territorin e tyre; megjithatë ky decentralizim nuk është shoqëruar me implikime buxhetore për këto shërbime, prandaj komunat po ballafaqohen me sfida serioze në gjetjen e burimeve financiare për të ofruar shërbime cilësore sociale.

Figura 14 Numëri i përfituesve nga skemat sociale dhe pensionale



Në komunën e Podujevës gjithësej 11482 persona përfitojnë nga skemat sociale dhe pensionale. Numrin më të lartë e përbejnë skemat pensionale të moshës, veteranëve të luftës dhe familjet e dëshmoreve (gjithësej 9424 persona përfitues në vitin 2018). 1028 familje kanë përfituar nga skemat e ndihmës sociale, kurse numri i antareve të atyre familjeve është 4833.

Në Komunën e Podujevës, shërbimet sociale ofrohen nëpërmjet Qendres për Punës Sociale (QPS) me gjithsej 11 zyrtarë të punësuar. Çështja e banimit ka qenë njëra ndër fushat kryesore të adresimit social të Komunës gjatë viteve të fundit. Mbështetja financiare e familjeve skamnore kryesisht është bërë për blerjen e barnave apo nevojave tjera shëndetësore. Komuna nëpërmjet subvencionëve ka përkrahë OJQ të ndryshme, sidomos ato të personave me aftësi të kufizuara.

Pavarësisht barrierave, është tejet e rëndësishme që komuna e Podujevës në bashkëpunim edhe me donatorë të garantoj jetësë më të dinjitetshme për të gjithë qytetarët nëpërmjet investimit

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

me të madh në politikat sociale si dhe nëpërmjet ndertimit dhe funksionalizimit të qendrës së kujdesit ditore për persona me aftësi të kufizuara dhe qendres kulturore-sociale të moshuar.

Roli i qendrave ditore për fëmijet me aftësi të kufizuara është vlerësuar sidomos në ofrimin e:

- Shërbimeve psikosociale/rehabilituese dhe këshilluese për fëmijë me aftësi të kufizuara dhe fëmijë nga kategoritë e tjera të cenuara;
- Këshillave psikologjike për prindër/kujdestarë të fëmijëve në nevojë;
- Ngritjen e vetëdijes dhe fuqizimin e prindërve për të avokuar për të drejtat e fëmijëve;
- Hapësirave për zhvillimin e praktikave më të mira në fushë e ofrimi të shërbimeve për fëmijë; dhe
- Informacionëve tek opinioni i gjerë për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.

Për me të përmirësuar, Komuna duhet të përkushtohet të përfshijë sa me shumë familje nën asistencë sociale në programet e subvencioneve në bujqësi, si dhe përfshirjes sa me të madhe të anëtarëve të familjeve nën asistencë në programet e aftësisimit profesional.

Ambienti dhe Shërbimet Publike

Menaxhim i Mbeturinave

Aktualisht nuk ka të dhëna të besueshme dhe të verifikuara për sasinë e mbeturinave që gjenërohen në Komunën e Podujevës. Sidoqoftë, në bazë të të dhënave nga deponia për grumbullimin e mbeturinave të raportuara nga 2015-2019, shohim se ka një dyfishim të sasisë së mbeturinave të deponuara nga 9 mijë ton në gati 12 mijë ton.

Spektori i menaxhimit të mbeturinave karakterizohet me nivele të ulëta të efikasitetit, investime private të kufizuara dhe përvojë jo-adekuate në përdorimin e teknologjisë moderne. Me ndryshimin e Ligjit për Mbeturinën në vitin 2012, Komunat janë përgjegjëse për rregullimin e përgjegjësive dhe obligimeve për menaxhimin e mbeturinave si dhe për zbatimin dhe organizimin e tyre.. Ligji gjithashtu specifikon që menaxhimi i mbeturinave duhet të bëhet nga subjekte të regjistruara, të licencuara dhe të kontraktuara. Për këtë në Komunën e Podujevës operojnë dy kompani për grumbullimin e mbeturinave si dhe është hartuar plani për menaxhimin e mbeturinave.

Sistemi i grumbullimit të mbeturinave karakterizohet nga shkalla e lartë e mbulimit territorial me shërbim të mbledhjes së mbeturinave, megjithatë frekuenca e mbledhjes së mbeturinave në zonat rurale mbetet e ulët.

- Zona Urbane: 7 ditë në javë
- Zona Sub-urbane: 2 deri 3 herë në javë
- Zona Rurale: 1 herë në javë.

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

Sipas të dhënave të Agjencionit Statistikor, komuna e Podujevës ka gjithsej 13,440 ekonomi familjare, kurse numri i ekonomive familjare që pranojnë shërbimin në vitin 2018 ka qenë 4,993, si rrjedhojë vazhdimisht krijohen deponi ilegale në fshatra dhe qytete.

Infrastruktura e grumbullimit të mbeturinave është e dobët dhe karakterizohet me një numër të pamjaftueshëm të konteniereve/shportave (kryesisht të dëmtuara). Pajisjet e transportimit të mbeturinave shpesh amortizohen, nuk funksionojnë mirë dhe janë kryesisht të pamjaftueshme për mbulim të plotë me shërbim. Mirëmbajtja e pajisjeve është po aq e pamjaftueshme. Për më tepër, kompanitë rrezikojnë qëndrueshmërinë financiare, për shkak (1) shtrirjes së gjërë të mbledhjes së mbeturinave, (2) numrit të vogël të familjeve që pranojnë shërbimin e mbledhjes së mbeturinave, dhe (3) të shkallës së ulët të arketimit.

Problemet kryesore nuk kanë të bëjnë vetëm me mbeturinat e amvisërisë. Problemi tjetër është se nuk ka sistem për mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave të veçanta (sipas Ligjit për Mbeturinat), siç janë: vajrat e përdorura, bateritë, akumulatorët, gomat, pajisjet elektrike, automjetet, mbeturinat bujqësore (mbeturinat e bimëve dhe kafshëve, përfshirë nën-produktet e kafshëve) mbeturinat mjekësore, barnat e skaduara, pesticidet dhe produktët e ngjashme të vjetruara. Për këtë arsye, komuna në bashkëpunim me AMMK duhet të rrisë kapacitetet e kompanive lokale për mbledhjen dhe transferimin e këtyre mbeturinave, në të njëjtën kohë të vetëdijësojë qytetarët dhe bizenset për shërbimet e veçanta që mund t'i kryejnë këto kompani.


Deponia komunale e Podujevës e ndertuar nga vitin 2004, me financim nga KE, kapaciteti i saj është rreth 1 milion m³ mbeturina. Ka filluar të punojë në vitin 2005 dhe ka nje jetëgjatësi të planifikuar prej 20 vitëve (data e planifikimit të mbylletjes 2025). Ndersa, jetëgjatësia sipas KMDK-se është parashikuar jo me e gjatë se deri në vitin 2040. Për këtë, komuna e Podujevës në bashkëpunim me AMMK dhe KMDK duhet të bejnë vleresimin nëse kjo deponi duhet të këtë jetëgjatësi kaq të gjatë për shkak se AMMK ka vlerësuar qe kjo deponi nuk është e favorshme për mjedisin si pasojë e përzierjes së ujërave sipërfaqësore me ujërat e ndotura të mbeturinave. Gjithashtu në këtë deponi nuk bëhet kompaktimi i rregullt i mbeturinave, që do të konsiderohej si vlerë e shtuar në zingjirin' e menaxhimit efektiv të mbeturinave.

Infrastruktura

Bazuar në të dhënat e marra nga sistemi ARIS që posedon komuna e Podujevës, deri më tani janë identifikuar gjithsej 1175 rrugë me një gjatësi prej 1089 km rrugë, prej të cilave rreth 71% e rrugëve janë të asfaltuara, 4% janë me kubëza dhe 25% e rrugëve janë me zhavor, që gjatë vlerësimit infrastrukturor nëpërmjet sistemit GIS kemi vërejtur se rreth 98.2% e vendbanimeve (lagje me më shumë se 15 shtëpi) janë të asfaltuara apo kubëzuara, ndërsa pjesa tjetër e rrugëve me zhavor janë kryesisht rrugica të shkurtra, më pak se 500m gjatësi.

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

Figura 15 Struktura infrastrukturore në Podujevë



Në anën tjetër, sa i përket trotuareve, kanalizimit fekal dhe atmosferik, ujësjellësit dhe ndriçimit të rrugëve, ka pasur përparim, megjithatë mbetet në nivele më të ulëta se sa asfaltimi.

Deri më tani nga 1089 km rrugë, 11% e tyre janë të inventarizuara me trotuare, 67% e tyre kanë kanalizim fekal, 18% e tyre kanë qasje në ujësjellës dhe vetëm 8% janë të ndriçuara.

Me përkrahje nga Komisioni European, komuna e Podujevës ka përfunduar shenjëzimin dhe vendosjen e emrave të rrugëve, gjithashtu ka realizuar digjitalizimin e rrugëve në sistemin ARIS, ndërsa obligim mbetet digjitalizimi i infrastrukturës përcjellëse.

Mirëmbajtja e infrastrukturës publike mbetet ndër sfidat kryesore. Aktualisht, komuna e Podujevës nuk ka ndonjë sistem të menaxhimit të infrastrukturës në funksion të evidentimit të saktë të dëmtimeve dhe nevojave për ndërhyrje. Kompanitë publike, privatë dhe qytetarët shpesh kryejnë punime duke bërë dëmtime të theksuara në infrastrukturën publike. Në këtë drejtim komuna duhet të monitorojë dhe inspektojë më intenzivisht kompanitë dhe qytetarët për respektimin e lejeve që kanë ndikim në infrastrukturën publike.

Kultura, Sporti dhe Turizmi

Kultura

Qytetaret e Podujevës kanë traditë të gjerë në kultivimin e kultures dhe artit. Dhenja e statusit dhe funksionalizimi i teatrit të qytetit "Avdush Hasani" është njeri ndër aktivitetet më të rëndësishme që është bërë për zhvillimin e jetës kulturore dhe artistike në Podujevë. Aktualisht teatri ka një strukturë të mirë organizative dhe vazhdimisht punon në prodhimin e shfaqjeve teatrore dhe në zbulimin e artistëve të rinje përmes edicionëve dhe kurseve të aktrimit. Ndër emblemat kryesore të kulturës në Podujevë është edhe festivali "Teatri Ndryshe" që është realizuar për më tepër se 10 edicionë duke mbledhur dhe shfaqur performanca artistike nga mbare Ballkani.


Podujeva ka gjithashtu shoqërinë kulturore dhe artistike "Josip Relja", kursin e kitares "Mirela". Për më shumë janë të regjistruara edhe 18 organizata tjera në fushën kulturore dhe artit. Komuna e Podujevës në vazhdimësi subvencionin këto organizata me qëllim të sigurimit të qendrueshmerisë së tyre. Megjithatë, njëra ndër sfidat mbetet mungesa e promovimit të vazhdueshëm të aktiviteteve kulturore dhe artistike në Podujevë.

Sporti

Sporti është një nga sektorët më të zhvilluar në Komunë e Podujevës, ku aktualisht janë të regjistruar 41 klube sportive prej të cilave 22 janë ende aktive dhe ushtrojnë veprimtari sportive.

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

Figura 16 Klubet sportive sipas statusit të funksionitmi



Sa i përket infrastruktures sportive, aktualisht Komuna e Podujeves posedon vetëm një palestër sportive që kryesisht përdoret nga klubet e Karatës, Kikboksit, Basketbollit, Hendbollit dhe Judos. Shfrytëzimi i këtyre hapsirave është falas për klubet sportive. Gjithashtu çdo vit subvencionojnë klubet sportive. Gjatë këtyre vitëve komuna ka investuar në ndërtimin e hapsirave sportive në qytet dhe fshatra, megjithatë njëra ndër sifdat mbetet ndërtimi i palestrës sportive si dhe shtegut të atletikes.

Turizmi


Turizmi për shumë vende është shtyllë e zhvillimit ekonomik lokal. Potenciali i zhvillimit të turizmit në Komunën e Podujeves është mjaft i lartë, sidomos në turizmin rural, malor, shendetësor dhe historik. Investimet direkte në zhvillim të turizmit kanë qenë shumë të ulta në raport me komunat tjera. Megjithatë, investimet në infrastrukture e kanë bërë me të lehtë qasjen ndaj zonave dhe objekteve turistike. Aktualisht në komunën e Podujeves nuk është funksional asnjë hotel, asnjë tour operator të konceptit 'InBound'; si dhe nuk ka asnjë muze lokal historiko-kulturor.

Këtë vit DZHE ka zhvilluar Strategjinë Sektoriale për Zhvillim të Turizmit 2019-2020, e cila parasheh një numër të madh të aktiviteteve që duhet ndërmarrë për fuqizim të turizmit në Podujeve. Megjithatë ndër aktivitetet më me prioritet mund të jenë, (1)shenjëzimi I të gjitha objekteve dhe zonave turistike (2) themelimi dhe funksionalizimi i muzeut historiko-etnografik të qytetit (3) digjitalizimi i shtigjeve të ecjes dhe vrapimit malor dhe vendosja e tyre në databazat ndërkombëtare të ecjeve në natyrë dhe (4) promovimi i potencialit turistik për investitor potencial.

Administrata

Administrata komunale në Podujevë është e organizuar nëpërmjet 11 drejtorive të cilat janë themeluar me statutin e Komunës. Aktualisht janë të punësuar 248 persona, prej të cilëve 29% janë femra.

Figura 17 Numri i të punësuarve sipas kategorisë dhe grupmoshës



Bazuar në të dhënat nga drejtoria e administratës, 40% e punonjësve në administratë komunale janë të moshës mbi 56 vjeçare, 26% i takojnë grupmoshës 46-55 vjeç. Numri më i lartë i punonjësve nga grupmosha mbi 56 vjet i

përkasin nivelit profesional dhe administrativ, kurse 69% e tyre janë me nivel të edukimit të mesëm.

Pavarësisht nivelit të edukimit sfide kryesore mbetet ndryshimi i shpejtë i burimeve njerëzore pasi që numër i madh i personave nga niveli administrativ dhe profesional do të pensionohen në 10 vitet e ardhshme, si rrjedhojë e mungesës së një sistemi të qëndrueshëm të ruajtjes së të dhënave dhe praktikave institucionale mund të humb memoria institucionale. Për këtë është e rëndësishme që për secilin prej punonjësve të rinjë të organizohen trajnime mirëseardhese lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë në punë.

Trajnimet dhe Zhvillimi

Trajnimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore është njëra ndër kompetencat kyçe të sektorit të menaxhimit të burimeve njerëzore. Nëpërmjet trajnimeve dhe programeve për zhvillim komuna duhet t'u siguroj punonjësve mjetet e nevojshme për suksesin e tyre, që në shumë raste, do të thotë t'iu ofrojnë punonjësve trajnime të vazhdueshme për t'i ndihmuar ata në punët e tyre

Komuna e Podujeves në bashkëpunim me donatorë të ndryshëm ka dërguar stafin komunal për të ndjekur kurse dhe programe të ndryshme të trajnimit. Megjithatë, është shumë e rëndësishme që komuna të analizoj kapacitetet e stafit nëpërmjet analizës së hendeqeve në shkathtësi dhe nevojave për trajnim. Pastaj, bazuar në raportin e analizave të nevojave për trajnime të organizoj trajnime të vazhdueshme me qëllim të ngritjes së performancës së punonjësve.

Sistemet e Menaxhimit

Sa i përket menaxhimit të qeverisjes nëpërmjet sistemeve elektronike, qeverisja komunale në Podujevë viteve të fundit ka funksionalizuar sisteme të menaxhimit dhe monitorimit elektronik:

- ✓ sistemin për menaxhimin e burimev njerëzore;
- ✓ sistemin e hyrje-daljeve të punonjësve;
- ✓ intranetin dhe sistemin e protokolimit elektronik; dhe
- ✓ sistemin elektronik të monitorimit të automjetëve.

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

Megjithatë, duhet avansim të sistemeve menaxhuese dhe lehtësuese në planifikim sic janë: sistemi elektronik i menaxhimit të projektëve i bazuar në praktikat në legjislacionin Kosovar dhe praktikat ndërkombetare, azhurnimi ARIS me të dhënat infrastrukturore, sistemi i monitorimit të rojeve të pyjeve, etj. Për më tepër, është shumë e nevojshme implementimi i standardit ISO9001 në funksion të rritjes së efikasitetit të menaxhimit, kontrollit dhe operimit.

Ofrimi i shërbimeve

Njëri ndër obligimet e Komunës është edhe ofrimi i shërbimeve publike administrative për qytetarët, bizenset dhe OJQ-të në formë të certifikatave, vendimeve, akt-vendimeve, pëlqimeve, etj. Komuna e Podujeves ofron rreth 97 shërbime publike administrative për qytetarët, bizenset dhe OJQ-të. Keto shërbime i ofron nëpërmjet 10 zyrave të gjendjes civile.

Niveli i digjitalizimit të ofrimit të shërbimeve është shumë i vogël, përveç disa certifikatave që mund të ofrohen në e-Kiosk, të gjitha shërbimet tjera ofrohen në menyrë fizike, gjithashtu edhe mënyra e aplikimit është e tillë. Në këtë drejtim komuna e Podujeves duhet të beje përpjekje, me mbështetje të donatoreve dhe të bazuar në praktikat me të mira të filloj digjitalizimin e ofrimit të shërbimeve publike administrative për qytetarët e saj, të funksionalizoj one-stop-shop për ofrimin e shërbimeve, dhe të rris numrin e-Kiosqeve dhe numrin e shërbimeve në zyrat e gjendjes civile.

Plani Strategjik

Vlerat, Vizioni dhe Misioni

VLERAT tona! Shtatë parimet udhëzuese në vijim janë vlera që pasqyrojnë bindjet tona për rolet dhe përgjegjësitë e komunës sonë:

1. **BASHKËPUNUES** – Ne punojmë së bashku në mënyrë efektive brenda komunës dhe në bashkëpunim me qytetarët, sektorin privat shoqërinë civile, komunitat e tjera dhe qeverinë qendrore;
2. **TË ORIENTUAR KAH SHËRBIMI** – Ne i dëgjojmë dhe u përgjigjemi qytetarëve tanë me përgjegjësi dhe i japim përparësi kënaqshmërisë së tyre për shërbimet tona;
3. **TË PËRQËNDRUAR NË REZULTATE** – Ne krijojmë synime për qytetarët, matim performancën tonë dhe raportojmë para publikut mbi suksesin tonë në përmbushjen e qëllimeve tona;
4. **LLOGARIDHËNËS** – Ne jemi të përgjegjshëm dhe transparent ndaj publikut për rolet, funksionet dhe veprimet tona si individë dhe si komunë;
5. **INOVATIV** – Ne jemi kreativ, mësojmë nga përvoja dhe rezultatet dhe kërkojmë mënyra të reja dhe efikase për të zgjidhur problemet dhe për t'i shërbyer qytetarëve;
6. **PROFESIONAL** – Ne mbështetemi në standarde të larta, aftësi, kompetenca dhe integritet gjatë kryerjes së detyrave tona në komunë;
7. **TË PAANSHËM DHE TË DREJTË** – Ne u shërbejmë të gjithë banorëve të komunës sonë duke promovuar drejtësi dhe mundësi dhe duke eliminuar pabarazitë.

Vizioni ynë:

Komunë e suksesshme me mundësi për të gjithë.

Misioni ynë:

Komuna e Podujevës e përkushtuar të ofrojë shërbime efektive që sigurojnë mirëqenie të qëndrueshme.

Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe Masat

Zhvillim I Qëndrueshëm Ekonomik.

Përmirësim i vazhdueshëm i ambientit të sektorit privat dhe nxitje e zhvillimit të hovshëm dhe të qëndrueshëm ekonomik me qëllim të gjenerimit të punësimit me vlerë.

1.1 Investime publike infrastrukturore që përmirësojnë ambientin e të bërit biznes

1.1.1 Zhvillimi i infrastrukturës bazë për operimin e minimum 30 bizneseve, me punësim të gjithëmbarshtëm 600 persona, deri në fund të 2022.

1.1.1.1 Zhvillimi i Studimit të Fizibilitetit për Zonën Industriale, deri në fund të 2020.

1.1.1.2 Ndërtimi dhe funksionalizimi i Zonës Industriale, deri në fund të 2022.

1.2 Nxitja e inovacionit përmes Partneriteteve Publiko Private (PPP)

1.2.1 Inicimi i 3 projekteve PPP dhe implementimi / përfundimi me sukses i njërit prej tyre, deri në fund të 2022.

1.2.1.1 Ngritja e Grupit Punues (GP) për PPP.

1.2.1.2 Ngritja e kapaciteteve për PPP.

1.2.1.3 Identifikimi i projekteve për PPP.

1.2.1.4 Përzgjedhja e 3 projekteve potenciale për PPP.

1.2.1.5 Sigurimi i fondeve për financimin e Studimeve të Fizibilitetit për projektet e përzgjedhura të PPP.

1.2.1.6 Hartimi i studimit të fizibilitetit për 3 projekte në PPP.

1.3 Stimulimi i zhvillimit ekonomik përmes Investimeve të Huaja Direkte ('IHD')

1.3.1 Tërheqja e 5 mil euro investime të huaja direkte, deri në fund të 2022.

1.3.1.1 Evidentim i nivelit (sektorët, nr. i punëtorëve, qarkullimi) të IHD aktuale.

1.3.1.2 Identifikimi i së paku 60 IHD (sektorët, shtetet 'DACH', kompanitë, përfshirë edhe diaspora).

1.3.1.3 Krijimi i kontakteve me së paku 20 IHD të përzgjedhur.

1.3.1.4 Pjesëmarrja në së paku 2 konferenca investive deri në fund të 2022.

1.3.1.5 Organizimi i konferencës investive në Podujeve, me së paku 10 IHD potencial, deri në fund të 2021.

1.4 Zvogëlimi i deficitit tregtar përmes rritjes së konkurrueshmërisë dhe eksportit të kompanive vendore.

1.4.1 Rritja e eksportit për 15% deri në fund të 2022 (nga ~5% në vit).

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

- 1.4.1.1 Evidentim i nivelit (sektorët, nr. i punëtorëve, qarkullimi) të eksportit aktual.
- 1.4.1.2 Në bashkëpunim me donatorë do të përkrahen eksportuesit dhe prodhuesit të gatshëm për eksport në rritjen e konkurrueshmërisë së tyre për tregun e jashtëm (vlerësimi i gatishmërisë për eksport, plane të hyrjes në tregje të huaja, ndërlidhje / përfaqësim / shitje, etj.)

1.5 Rritja e prodhimit lokal (zëvendësim i importit)

1.5.1 Rritja e prodhimit për 15%, deri në fund të 2022 (~5% në vit)

- 1.5.1.1 Evidentim i nivelit (sektorët, nr., shumat) të prodhimit aktual.
- 1.5.1.2 Përkrahje prodhuesve në rritjen e -- konkurrueshmërisë së tyre, prodhimit (zvogëlimit të importit), dhe rritjen e potencialit për eksport (vlerësim, plane për zgjerim të kapacitetit prodhues, marketing, shitje), rritje të cilësisë.
- 1.5.1.3 Ndarja e subvencioneve (~2 mil euro gjatë 2020-2022), për sektorët në vijim: (1) Pemtari; (2) Perimtari; (3) Bletari; (4) Shpeztari; (5) Blegtori; (6) Turizëm rural.

1.6 Nxitja e ndërmarrësisë tek të rinjtë, përmes hapjes së bizneseve të reja ('startups') të qëndrueshme.

1.6.1 Krijimi i minimum 10 bizneseve të reja, me punësim total minimum 50, për çdo vit.

- 1.6.1.1 Evidentim i nivelit (sektorët, nr. i punëtorëve, qarkullimi, eksporti) të bizneseve të reja.
- 1.6.1.2 Studim i fizibilitetit për krijimin e Inkubatorit të Biznesit në Podujevë "PoSTART", deri në fund të 2020. PoStart duhet të jetë një hapsirë e mjaftueshme për 15-20 grupe të rinjesh llapjanë, ku idetë e tyre për ndërmarrësi do të zhvillojnë në plane konkrete të bizneseve, brenda periudhës 6 muajshe për çdo ide biznesi. Gjithashtu, PoStart do të shfrytëzohet si mjedis ku bizneset e suksesshme të Podujevës do të mund të japin kontributin e tyre në zhvillimin e atyre biznesplaneve apo edhe të bëhen bashkë-investues në bizneset e reja që do të krijohen. Prioriteti i jepet sektorit të bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit.
- 1.6.1.3 Operacionalizimi i PoSTART, deri në maj të vitit 2022.

Zhvillim i Qëndrueshëm Social.

Fuqizimi i qytetarëve për ta realizuar potencialin e tyre të plotë, përmes sigurimit të mundësive të barabarta në arsim, shëndetësi dhe jetë sociale cilësore.

1.7 Përmirësimi i kushteve të jetesës

1.7.1 Asfaltim dhe kubëzim i 80 km rrugë deri në fund të 2022.

1.7.1.1 Asfaltim i 75 km rrugë që aktualisht janë të mbuluar me zhavorr në fshatra dhe në qytet.

1.7.1.2 Kubëzimi i së paku 5 km rrugica në fshatra dhe qytet.

1.7.2 Funkcionalizim i 10,000 trupave ndriçues eficient deri në fund të 2022.

1.7.2.1 Evidentimi i gjendjes ekzistuese të ndriçimit në të gjitha lagjet dhe fshatrat e Podujevës dhe futja në sistemin GIS.

1.7.2.2 Prioritizimi i rrugëve dhe lagjeve për instalim të trupave ndriçues

1.7.2.3 Instalimi i 10,000 trupave ndriçues në lagje dhe fshatra

1.7.3 Shtrirje e 15 km të rrjetit të kanalizimit deri në fund të 2022.

1.7.3.1 Evidentimi i gjendjes ekzistuese të rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik

1.7.3.2 Prioritizimi i lagjeve dhe fshatrave ku duhet të bëhet zgjerimi i rrjetit të kanalizimit

1.7.3.3 Shtrirja e kanalizimit për së paku 15 km në fshatra

1.7.3.4 Deri në fund të vitit 2022 përfundon ndërtimi i kolektorit për trajtimin e ujërave të zeza në Podujevë

1.8 Sistem gjithëpërfshirës dhe llogaridhënës i arsimit, me menaxhim cilësor dhe mësimdhënës të përgatitur, me mjedise krijuese dhe kushte që sigurojnë edukim dhe arsim cilësor për nxënësit.

1.8.1 Ngritje e kapaciteteve të Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) në planifikim strategjik dhe monitorim, deri në mars 2020.

1.8.1.1 Zhvillimi dhe aprovimi i planit komunal për zhvillim të arsimit 2021-2026, deri në fund të 2020.

1.8.1.2 Trajnim i stafit të DKA-së për 'Planifikim Strategjik dhe Operacional', deri në mars 2020.

1.8.1.3 Përmirësimi i kapaciteteve për të mbledhur, analizuar dhe menaxhuar të dhënat relevante për ngritjen e cilësisë dhe rritjen e qasjes në arsim, deri në maj 2020.

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

- 1.8.2 Përmirësimi i cilësisë në menaxhim dhe mësimdhënie, përmes vlerësimit sipas metodologjisë '360', ku nxënësit vlerësojnë mësimdhënësit, mësimdhënësit menaxhmentin e shkollës, dhe menaxhmenti i shkollës mësimdhënësit, nga qershori i 2021 dhe pastaj çdo vit.**
- 1.8.2.1 Adoptimi i metodologjisë për vlerësim bazuar në rregullat në fuqi deri në qershor 2020.
 - 1.8.2.2 Informimi i mësimdhënësve, nxënësve dhe menaxhmentit të shkollave për metodologjinë dhe procesin e vlerësimit deri në janar 2021.
 - 1.8.2.3 Organizimi i vlerësimit të mësimdhënësve, menaxhmentit të shkollave nga qershori deri në tetor 2021.
 - 1.8.2.4 Analizimi i rezultateve të vlerësimit dhe përgatitja e planit për përmirësim bazuar në rezultatet deri në janar 2022.
 - 1.8.2.5 Ceremonia vjetore e përzgjedhjes së top drejtorëve të shkollave, mësimdhënësve dhe nxënësve, bazuar në rezultatet e vlerësimit, duke filluar nga tetori i vitit 2021 dhe më pas çdo vit.
- 1.8.3 Përmirësimi i menaxhimit të shkollave, përmes funksionalizimit dhe trajnimit të së paku 70% (~140 anëtarë) të këshillave drejtues të shkollave (për 'rolet dhe funksionet' e këtyre këshillave), deri në fund të 2021.**
- 1.8.3.1 Zhvillimi i programit të trajnimit për rolet, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e këshillave të shkollave deri në qershor 2020.
 - 1.8.3.2 Përgatitja e kalendarit të trajnimeve për këshillat drejtues të shkollave deri në gusht 2020.
 - 1.8.3.3 Organizimi i të paktën 30 ditë trajnimi sipas kalendarit të aprovuar deri në fund të 2021.
- 1.8.4 Përmirësimi i cilësisë në arsim, përmes funksionalizimit të shërbimeve pedagogjike dhe psikologjike në të paktën 70% të shkollave, deri në fund të 2022.**
- 1.8.4.1 Përzgjedhja e pedagogëve dhe psikologëve në shkolla sipas udhëzimeve administrative të MASHT-it, për cdo vit të rritet 10-15% mbulimi i shkollave.
 - 1.8.4.2 Për cdo vit, të bëhet organizimi i trajnimeve për pedagogët dhe psikologët e rinjë në shkolla për lidhur me ofrimin e shërbimeve efikase, rolin dhe funksionin e tyre.
 - 1.8.4.3 Ngritja e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të shërbimeve pedagogjike dhe psikologjike, bazuar në rregullat në fuqi, deri në qershor 2020.
 - 1.8.4.4 Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi i rregullt mbi punën e shërbimeve pedagogjike dhe psikologjike në shkolla.
- 1.8.5 Përmirësimi i cilësisë në arsim, përmes rritjes së aftësive të së paku 70% të koordinatorëve të cilësisë në monitorim të zbatimit të kurikulës së re, në vit.**
- 1.8.5.1 Zhvillimi i programit të trajnimit (përfshirë formatin e raportimit) për koordinatorët e cilësisë për monitorim, vlerësim të kurikulës së re deri në qershor 2020.

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

1.8.5.2 Organizimi i së paku 1 trajnimi në vit për koordinatorët e cilësisë në shkolla për monitorim, vlerësim dhe raportim.

1.8.6 Përmirësimi, rritja dhe/ose pajisja me teknologji dhe mjete konkretizuese të hapsirave fizike për mësim dhe praktikë, respektivisht laboratoreve kimike / biologjike, kompjuterike, sportive, përmirësimi i oborreve shkollore, si dhe ndërtimi i shkollave të reja, deri në fund të 2022.

1.8.6.1 Përmirësimi, rritja dhe/ose pajisja me teknologji dhe mjete konkretizuese të hapsirave fizike për mësim dhe praktikë, të laboratoreve kimike / biologjike në 5 shkollat

1.8.6.2 Përmirësimi, rritja dhe/ose pajisja me teknologji dhe mjete konkretizuese të hapsirave fizike për mësim dhe praktikë, të laboratoreve kompjuterike në 7 shkollat.

1.8.6.3 Përmirësimi, rritja dhe/ose ndërtimi i terreneve sportive në 5 shkolla

1.8.6.4 Përmirësimi i oborreve në 5 shkollat

1.8.6.5 Ndërtimi i 2 shkollave të reja

1.9 Infrastrukturë e fortë dhe shërbime shëndetësore cilësore që u mundësojnë qytetarëve të gëzojnë shëndet të mirë fizik dhe mendor.

1.9.1 Përfundimi i ndërtimit dhe funksionalizimi i Repartit të Urgjencës, deri në fund të 2022.

1.9.1.1 Pajisja e Repartit të Urgjencës me mjete medicinale, sipas Ligjit për Shëndetësi dhe Udhëzimit Administrativ (UA): 09/2014., deri në fund të 2022.

1.9.2 Renovimi i dhe ndërtimi i Ambulantave të Mjeksisë Familjare (AMF), deri në fund të 2022.

1.9.2.1 Renovimi i brendshëm dhe rregullimi i hapësirave të jashtme të 5 AMF-ve ekzistuese, deri në fund të 2022.

1.9.2.2 Ndërtimi i AMF-ve në fshatin Dumnicë dhe Dobratin, deri në fund të 2022.

1.9.3 Rritja e numrit të shërbimeve laboratorike në QKMF, QMF dhe AMF, nga janari 2022.

1.9.3.1 Pajisja e QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve me pajisje të nevojshme laboratorike për kryerjen e analizave biokimike dhe hematologjike të gjakut dhe analizave të urinës, deri në fund të 2021.

1.9.3.2 Gjithsej 31 shërbime laboratorike do të mund të kryhen në QKMF (gjaku: glikemia , urea / kreatinina , bilirubina – totale , bilirubina – direkte , AST – , ALT , Kolesterolit , Trigliceridet , Sedimentimi , numri total i qel. të kuqe , hematokriti , hemoglobina , numri total i leukociteve , numri i trombociteve , koha e gjakderdhjes , koha e koagulimit të gjakut , Fe , Elektrolitet , glikemia (glukometer) , Testi i shiritave të

DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2020-2022

glukozës; urina: pamja, ngjyra, era, pH, specif, , Proteina, glukoza, ketone, gjaku, esteraz e luk. , ekzaminimin mikroskopik i urinës së sedimentuar , testi i shtatzanisë , ASTO , CRP , Faktorët Rheumatik , TSH, T3 dhe T4 , Hemoglobina e glukoziduar , Fraksionet e yndyrërave), nga janari i 2022.

1.9.3.3 Gjithsej 27 shërbime laboratorike do të mund të kryhen në QMF (gjaku: glikemia, urea / kreatinina , bilirubina – totale , bilirubina – direkte , AST , ALT , Kolesterol , Trigliceridet , Sedimentimi , numri total i qel. të kuqe , hematokriti , hemoglobina , numri total i leukociteve , numri i trombociteve , glikemia (glukometer) , Testi i shiritave të glukozës; urina: pamja, ngjyra, era, pH, specif, , Proteina, glukoza, ketone, gjaku, esteraz e luk. , ekzaminimin mikroskopik i urinës së sedimentuar , testi i shtatzanisë , ASTO , CRP , Faktorët Rheumatik , TSH, T3 dhe T4 , Hemoglobina e glukoziduar , Fraksionet e yndyrërave), nga janari i 2022.

1.9.3.4 Gjithsej 6 analiza do të mund të kryhen në AMF (gjaku: glikemia, glikemia me glikometër, hemoglobina, testi i shiritave të glukozës; urina: pamja, ngjyra, era, pH dhe specif), nga janari i 2022.

1.10 Jetesë më të dinjitetshme për të gjithë qytetarët.

1.10.1 Ofrimi i kushteve për jetesë të dinjitetshme familjeve pa strehim adekuat, deri në fund të 2022.

1.10.1.1 Ndërtimi i 20 shtëpive për familjet pa strehim adekuat, deri në 2022.

1.10.2 Funkcionalizimi i hapsirës adekuate për strehimin / banimin dhe përkujdesjen e 30 pleqve mbi 65 vjeç, raste sociale që nuk kanë asnjë të ardhur financiare, deri në fund të 2022.

1.10.2.1 Zhvillimi i planit të ndërtimit, funksionalizimit dhe operimit të 'Shtëpisë së Pleqve' (SHP), hapsirë për strehimin dhe përkujdesjen ndaj pleqve që kategorizohen si raste sociale, deri në maj të 2020.

1.10.2.2 Sigurimi i financimit për ndërtimin e SHP, deri në fund të 2020.

1.10.2.3 Ndërtimi i SHP, deri në fund të 2022.

